



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

g105
Nr. g105 Prot.

Tiranë, më 18.5. 2022

URDHËR

Nr/148 datë 18.5.2022

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR AUTORIZIMIN E PERSONAVE JURIDIKË PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE NË METROLOGJINË LIGJORE DHE PËR AUTORIZIMIN E PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË PËR KRYERJEN E SHËRBIMIT TË RIPARIMIT TË INSTRUMENTAVE MATËSE, SI DHE PËR MONITORIMIN E AKTIVITETIT/PERFORMANCËS SË TYRE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 39, pika 4 të ligjit nr.126/2020 “Për metrologjinë”, si dhe me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë:

URDHËROJ:

- I. Miratimin e Rregullores “Për autorizimin e personave juridikë për kryerjen e veprimtarive në metrologjinë ligjore dhe autorizimin e personave juridikë e fizikë për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumentave matës”, bashkëlidhur këtij Urdhëri, në të cilin përshkruhen kërkesat dhe procedurat për dhënien e këtyre autorizimeve.
- II. Urdhëri Nr. 7025, datë 24.08.2017 “Për miratimin e rregullores për autorizimin e personave juridikë për kryerjen e veprimtarive në metrologjinë ligjore dhe autorizimin e personave juridikë e fizikë për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumentave matës”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MHNISTËR

Delina IBRAHIMAJ

RREGULLORE

“PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR AUTORIZIMIN E PERSONAVE JURIDIKË PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE NË METROLOGJINË LIGJORE DHE PËR AUTORIZIMIN E PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË PËR KRYERJEN E SHËRBIMIT TË RIPARIMIT TË INSTRUMENTAVE MATËS, SI DHE PËR MONITORIMIN E AKTIVITETIT/PERFORMANCËS SË TYRE”

Kjo rregullore përshkruan kërkesat dhe procedurat për autorizimin e personave juridike për kryerjen e veprimtarive (shërbimeve) në metrologjinë ligjore, si dhe autorizimin e personave juridikë për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumentave matës, që përdoren në metrologjinë ligjore, përvèç rasteve kur verifikimi i të gjithë instrumentave matës, të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm kryhet eksluzivisht nga një person juridik privat, i autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi. Sipas kësaj Rregulloreje:

1. Autorizimi i personave juridikë për kryerjen e verifikimit të instrumentave matës ligjërisht të kontrolluar jepet nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) mbështetur në kërkesat dhe procedurën e përshkruar në Pjesën 1, bashkëngjitur.
2. Autorizimi i personave juridikë për kryerjen e ekspertizës metrologjike jepet nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) mbështetur në kërkesat dhe procedurën e përshkruar në Pjesën 2, bashkëngjitur.
3. Autorizimi i personave juridikë ose fizikë për kryerjen e riparimit, verifikimit dhe vulosjes pas riparimit të instrumentave matës ligjërisht të kontrolluar, jepet nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) mbështetur në kërkesat dhe procedurën e përshkruar në Pjesën 3, bashkëngjitur.

PJESA 1

“KËRKESAT DHE PROCEDURAT PËR AUTORIZIMIN E PERSONAVE JURIDIKE PËR KRYERJEN E VERIFIKIMIT TË INSTRUMENTAVE MATËS LIGJËRISHT TË KONTROLLUAR”

Pika 1

Me këtë rregullore përcaktohen kërkesat, të cilat duhet të plotësojë personi juridik si dhe procedura për marrjen e autorizimit për verifikimin e instrumentave matës ligjërisht të kontrolluara, si dhe për vulosjen e tyre.

Pika 2

Autorizimi për verifikimin e instrumentave matës ligjërisht të kontrolluar jepet vetëm për instrumenta të përcaktuar në përputhje me Nenin 39, paragrafi 1, paragrafi 2, i Ligjit Nr. 126/2020, datë 15.10.2020 “Për Metrologjinë” dhe për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, ose në një zonë juridikacioni të kufizuar, sipas kritereve dhe rregullave të përcaktuara me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

Pika 3

Për marrjen e kësaj të drejte personi juridik duhet të plotësojë këto kushte:

I. Të demostrojë përputhshmërinë ligjore dhe financiare:

- a) Të plotësojë kërkesën tip, sipas Aneksit 1.1 bashkëlidhur këtij urdhëri.
- b) Dokumentat ligjorë që vërteton statusin e personit juridik:
 - i Ekstrakt i Regjistrat Tregtar nga QKB
 - ii Ekstrakt Historik i Regjistrat Tregtar nga QKB
 - iii NIPT i shoqërisë aplikuese
- c) Dokument nga autoritetet përkatese që vërteton se aplikanti nuk është në proces gjyqësor administrativ, civil dhe penal. Vërtetimet të jenë në emër të shoqërisë dhe administratorit të saj.
- ç) Dokument nga autoritetet përkatese, që vërteton se aplikanti nuk është në proces përmbarimor. Vërtetimet të jenë në emër të shoqërisë dhe administratorit të saj.
- d) Dokument nga autoritetet përkatese, që vërteton se aplikanti ka shlyer të gjitha detyrimet vendore në fushën e tatim-taksave.
- dh) Vërtetim që ka plotësuar detyrimet tatimore, nga Administrata Tatimore.
- e) Vërtetim që ka plotësuar detyrimet e sigurimeve shoqërore, nga Administrata Tatimore.

ë) Deklaratë e aplikuesit se për aktivitetin që kërkon të autorizohet, do të përdorë tarifat, të përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse.

Kërkesat e mësipërme, të përcaktuara në gërmat b) deri ë), përbushen me plotësimin e Formularit të Vetëdeklarimit, i cili ndodhet në Aneksin nr. 1.3 të këtij Urdhëri.

II. Të demostrojë përputhshmërinë teknike:

a) Subjekti që kërkon autorizim për verifikimin e instrumentave matës ligjërisht të kontrolluara duhet të disponojë laborator testimi të përshtatshëm për aktivitetin verifikues që do të kryejë. Subjekti që kërkon autorizim për verifikimin e instrumentave matës, si matësit e energjisë elektrike, matësit e ujit, duhet të jetë paraprakisht i akredituar sipas Standardit ISO 17025 dhe ISO 17020, për subjektin i cili kërkon autorizim për verifikimin e instrumentave matës jashtë fushave të sipërpërmendura duhet të jetë paraprakisht i akredituar me ISO 17020.

b) Lista e testimeve të akredituara duhet të mbulojë edhe testimet që kërkohen për autorizimin nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM).

c) Dokumentacionin përkatës për laboratorin, që aplikanti do të përdorë për kryerjen e shërbimit, për të cilin aplikon me të dhënat për hapësirën, vendndodhjen, plan vendosjen dhe kushtet ambientale. Aplikanti duhet të dorëzojë aktin e pronësisë së ambientit laborator, ose kontratën e qirasë të paktën për një afat 4 (katër) vjeçar.

ç) Dokumentacionin për personelin teknik e administrativ, që do të kryejë shërbimin e verifikimit periodik si: CV, kontratë pune, diplomat e studimeve që kanë kryer, dëshmitë e kualifikimeve që kanë kryer (certifikatat e trajnimeve).

d) Kopje të procedurës teknike që aplikanti do të zbatojë gjatë kryerjes së shërbimit metrologjik.

dh) Dokumentacioni teknik për bazën etalonuese dhe të gjithë instrumentat kontrollues, shoqëruar me certifikatat përkatëse të kalibrimit, të cilat të datojnë jo më vonë se 6 muaj para datës së aplikimit. Certifikatat e kalibrimit duhet të janë të lëshuara nga NMI që kanë deklaruar aftësitë matëse kalibruese (CMC) në database e BIPM, ose nga një laborator i akredituar nga një trupë akreditimi nënshkruese e Marrëveshjes shumëpalëshe të Organizatës Europiane të Akreditimit (EA MLA) ose nënshkruese e Marrëveshjes së Njohjes Reciproke (ILAC MRA).

e) Dokumentacioni i sistemit të menaxhimit të cilësisë së laboratorit, për subjektin që kërkon autorizim për verifikimin e instrumentave matës si matësit e energjisë elektrike, matësit e ujit duhet të jetë sipas Standardit ISO 17025 dhe ISO 17020, për subjektin i cili kërkon autorizim për verifikimin e instrumentave matës jashtë fushave të sipërpërmendura duhet të jetë sipas standardit ISO 17020.

ë) Të dhëna mbi registrat e verifikimit që aplikanti duhet të mbajë.

*I gjithë dokumentacioni i mësipërm duhet të jetë në gjuhën shqipe, original, ose i noterizuar duke u njehuar me originalin.

Pika 4

Procedura për dhënien e autorizimit për verifikim fillon me plotësimin dhe nënshkrimin nga ana e përfaqësuesit të personit juridik, të kërkesës sipas modelit bashkëngjitur kësaj Rregulloreje (Aneksi 1.1).

Pika 5

Procedurat për marrjen e autorizimit janë si më poshtë:

- a) Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM), pas marrjes së kërkesës, ia drejton Drejtorisë së Metrologjisë Ligjore (DML), e cila brenda ditës shprehet në mbështetje të pikës 2 të nenit 39, të Ligjit nr. 126/2020, datë 15.10.2020 “Për metrologjinë” nëse autorizimi i kërkuar për verifikimin përkatës kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.
- b) Në rastin kur DML-ja shprehet se autorizimi i kërkuar për verifikim kryhet nga DPM-ja subjektit i kthehet menjëherë përgjigje përfundimtar.
- c) Në rastin kur DML-ja shprehet se shërbimi, objekt i autorizimit nuk kryhet nga DPM-ja, Drejtori i Përgjithshëm i Metrologjisë ngre grupin e punës për vlerësimin e kërkesës dhe dosjes së paraqitur nga subjekti, në përbërje të të cilat duhet të ketë: një përfaqësues nga Drejtoria e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale në varësi të fushës së aplikimit, një përfaqësues nga Drejtoria e Metrologjisë Ligjore, një përfaqësues nga Sektori i Sigurimit të Cilësisë, një përfaqësues nga Sektori i Financës dhe një përfaqësues nga Sektori Juridik.
- ç) Brenda 20 ditëve nga data e aplikimit të subjektit, Grupi i Vlerësimit, i ngritur me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, shqyrton dokumentacionin e aplikimit, të përcaktuar në pikën 3. Nëse është e nevojshme, aplikanti ftohet të marrë masa korriguese, jo më vonë se 7 ditë nga shkresa e DPM.
- d) Në rast se dosja e aplikantit përmban dokumentacion të rregullt, Grupi i Vlerësimit kryen vizitën në ambientet e personit juridik, brenda afatit 30 ditor nga marrja e kërkesës. Gjatë vizitës vlerësuese, kontrollohet gjendja e etaloneve dhe instrumentave matës, certifikatat e tyre, udhëzimet tekniko-administrative, si është implementuar sistemi i menaxhimit, si dhe vërtetësia e të gjithë të dhënave të dërguara paraprakisht nga ana e personit juridik.
- dh) Në përfundim të procesit, grupi i vlerësimit harton raportin përfundimtar, të cilin ia paraqet Drejtorit të Përgjithshëm të DPM-së, ku të paraqitet vlerësimi përfundimtar çdo kriter ligjor, teknik dhe administrativ.
- e) Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, vendos për nxjerrjen e Vendimit Administrativ, brenda 60 ditëve nga aplikimi. Vendimi Administrativ është i vlefshëm përfundimtar një periudhë 4 (katër) vjeçare.

Pika 6

Menjëherë personit juridik i jepet Vendimi Administrativ i autorizimit (sipas modelit bashkëngjitur - Aneksi 1.4) për ushtrimin e së drejtës për verifikimin dhe vulosjen e instrumentave matës. Juridiksioni dhe zona e vlefshmërisë së tij për ushtrimin e së drejtës për verifikim, përcaktohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM).

Pika 7

Me marrjen e autorizimit, personi juridik ka të drejtë të kryejë aktivitetet verifikuese të përshkruara, të vulosë instrumentat matës të verifikuar dhe t'i lëshojë pronarit të tyre dokumentin që vërteton këtë verifikim.

Dokumenti dhe vula ligjerojnë përdorimin e mjetit matës për një periudhë kohe deri në verifikimin e rradhës të parashikuar në aktet nën ligjore për metrologjinë.

Pika 8

Nëse personi juridik i autorizuar kërkon të shtojë, ose të heqë nga përdorimi instrumenta matës të ndryshëm apo kërkon të bëjë ndryshime të procedurave dhe/ose personelit, atëherë ai njofton menjëherë me shkrim Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë (DPM).

Nëse personi juridik i autorizuar kërkon të shtojë instrumenta matës të ndryshëm Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) vlerëson dokumentacionin e aplikimit, dhe nëse dosja përban dokumentacion të rregullt realizon vizitën vlerësuese dhe testimjet përkatëse, nëpërmjet një grapi të ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm brenda 30 ditëve, nga data e dorëzimit të kërkesës nga personi juridik, në përbërje të të cilit duhet të ketë: një përfaqësues të Drejtorisë së Metrologjisë Shkencore dhe Industriale në varësi të fushës së aplikimit, një përfaqësues nga Drejtoria e Metrologjisë Ligjore, një përfaqësues nga Sektori i Sigurimit të Cilësisë, një përfaqësues nga Sektori i Financës dhe një përfaqësues nga Sektori Juridik.

Ky grup i paraqet Drejtorit të Përgjithshëm një relacion, në të cilin paraqitet përbushja ose jo e kërkesave përkatëse.

Drejtori i Përgjithshëm harton një ndryshim Vendimi Administrativ, në të cilin reflektohen ndryshimet në instrumenta, procedura.

Pika 9

I autorizuari nuk ka të drejtë të bëjë verifikime jashtë zonës së juridiktionit të autorizuar, si dhe nuk ka të drejtë të ndërhyjë aty ku verifikimi është kryer nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM).

Pika10

I autorizuari, për subjektet që ndodhen në zonën e juridiktionit të tij dhe që nuk pranojnë të verifikojnë instrumentat matës ligjërisht të kontrolluar që kanë në përdorim, do të njoftojë me shkrim organet e inspektimeve metrologjik dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë.

Pika 11

Pas dhënes së autorizimit, i bëhen kontolle monitoruese/performancës nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM), me përjashtim të rasteve kur funksionet monitoruese të përformancës së personave juridik privat, të autorizuar për kryerjen e veprimtarive në metrologjinë ligjore, u janë caktuar autoriteve të tjera shtetërore me ligj ose kontrata të miratuara me ligj. Monitorimi të kryhet të paktën 1 (një) herë në vit, nëpërmjet një grapi të ngritur me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm ku në përbërje të të cilit duhet të ketë: një përfaqësues nga Drejtoria e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale në varësi të fushës së aplikimit, një përfaqësues nga Drejtoria e Metrologjisë Ligjore, një përfaqësues

nga Sektori Juridik, një përfaqësues nga Sektori i Sigurimit të Cilësisë dhe një përfaqësues nga Sektori i Financës.

Gjatë vizitës monitoruese/performancës, DPM kontrollon:

- a) Si janë zbatuar kërkesat e Sistemit të Mënaxhimit të Cilësisë, (regjistrime teknike dhe regjistrime të cilësisë të bëra për periudhën që vlerësohet).
- b) Certifikatat e kalibrimit të instrumentave matës dhe instrumentave ndihmës.
- c) Testime konformiteti të realizuar me instrumentat matës.
- g) Personelin dhe aftësitë teknike të tyre.
- d) Tarifat e përdorura.

Pika 12

Autorizimi është i vlefshëm për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

Në përfundim të afatit 4 vjeçar të autorizimit, personi juridik duhet të njoftojë dhe t'i bëjë përsëri kërkesë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) duke kërkuar ri-autorizim.

Në këtë rast, personi juridik duhet të ndjekë të njëjtën procedurë të përshkruar në këtë Urdhër, për dhënien e autorizimit.

Pika 13

Autorizimi është i pavlefshëm, kur:

- a) Mbaron afati i vlefshmërisë së autorizimit.
- b) Drejtori i Përgjithshëm i Metrologjisë nxjerr vendim për anullimin e autorizimit.
- c) Personi juridik i autorizuar heq dorë, me shkrim, nga autorizimi.

Pika 14

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë shfuqizon Vendimin për Autorizim, në rastet kur:

- a) Personi Juridik i autorizuar kryen shërbime verifikimi, në kundërshtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në dhënien e autorizimit nga e DPM-së.
- b) Personi Juridik i autorizuar nuk përdor instrumenta të kalibruar nga NMI që ka deklaruar aftësitë matëse kalibruese (CMC) në database e BIPM, ose nga një laborator i akredituar nga një trupë akreditimi nënshkruese e Marrëveshjes shumëpalëshe të Organizatës Europiane të Akreditimit (EA MLA) ose nënshkruese e Marrëveshjes së Njohjes Reciproke (ILAC MRA) ose nga një laborator kalibrues i akredituar specifikisht për kalibrimin që kërkohet nga një organizëm akreditues i cili është nënshkrues i ILAC-MLA ose Marrëveshjeve Rjonale të Njohura nga ILAC në fushën e kalibrimit.
- c) Personi Juridik i autorizuar përdor instrumenta, të cilat janë jashtë klasës së saktësisë, të parashikuar në autorizim, ose në kontratën e shërbimit.
- g) Personi Juridik i autorizuar nuk mirëmban dokumentacionin e plotë dhe regjistrimet sipas kërkesave të parashikuara në standarde.

d) Personi Juridik i autorizuar nuk përdor tarifa verifikimi, të përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse.

dh) Personi Juridik i autorizuar ka bërë ndryshime në kushtet e dhënes së autorizimit, pa miratimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

e) Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë shfuqizon autorizimin kur cënohen rëndë detyrimet e caktuara në ligjin Nr. 126/2020, datë 15.10.2020 “Për Metrologjinë” dhe aktet e nxjerra në zbatim të tij.

ë) Personit juridik të autorizuar për verifikimin e instrumentave mates, si matësit e energjisë elektrike, matësit e ujit, i është hequr akreditimi sipas standardeve ISO 17025 dhe ISO 17020. Personit juridik të autorizuar për verifikimin e instrumentave matës jashtë fushave të sipërpërmendura i është hequr akreditimi sipas standardit ISO 17020.

Pika 15

Menjëherë pas marrjes së vendimit për shfuqizimin e Autorizimit, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) njofton me shkrim personin juridik.

Pika 16

Personit juridik dhe fizik, të cilil i është shfuqizuar autorizimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM), i hiqet gjithashtu e drejta për riaplikim për autorizim për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

Personit juridik, i cili heq dorë vetë nga autorizimi, i hiqet e drejta për riaplikim për autorizim për një periudhë 10 (dhjetë) vjeçare.

Pika 17

Tarifat për dhënien e autorizimit për verifikim dhe të drejtës për vulosje për personat juridikë përcaktohen sipas akteve nënligjore.

Pika 18

Anekset e mëposhtme janë plotësime të kësaj Rregulloreje:

Aneksi 1.1 Formulari Tip i Aplikimit për dhënien e autorizimit

Aneksi 1.2 Lista e dokumentave për aplikim

Aneksi 1.3 Formulari Tip i vetëdeklarimit

Aneksi 1.4 Formulari Tip i Vendimit administrativ për dhënien e autorizimit

ANEKSI nr. 1.1

FORMULARI I KËRKESËS

KËRKESË

**PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR VERIFIKIM TË INSTRUMENTAVE
MATËSE LIGJËRISHT TË KONTROLLUARA**

1. Emërtimi dhe adresa e subjektit (laboratorit) verifikues
.....
2. Emri, mbiemri i përfaqësuesit të subjektit verifikues
.....
3. Ndërtesa dhe kushtet ambientale të laboratorit
.....
4. Emri, mbiemri dhe kualifikimi i personelit verifikues
.....
5. Etalonët, instrumentat matës kontrolluese (që do të përdoren në aktivitetin e verifikimit) dhe karakteristikat e tyre
.....
6. Llojet e instrumentave matëse që subjekti është në gjendje të verifikojë
.....
7. Rregulloret që përdorën për përcaktimin e treguesve metrologjik
.....
8. Deklaroj se nuk kryej riparimin e instrumentave matës ligjërisht të kontrolluar.
9. Deklaroj se njoh:
 - a. Ligjin Nr. 126/2020, datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë"
 - b. Rregulloren për autorizimin e personave juridike për kryerjen e veprimitarive në metrologjinë ligjore dhe autorizimin e personave juridike ose fizikë për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumentave matëse
 - c. Të gjitha aktet nënligjore që i pëkasin verifikimit.
10. Gjithashtu marr përsipër :
 - a. të repektoj plotësisht rregullat dhe detyrimet që permbajnë dokumentet e mësipërme
 - b. të bëj pagesën e tarifës përkatëse në Ilogarinë e DPM
 - c. të plotësoj regullisht dhe tia paraqesë DPM-se (me kërkësë të saj) regjistrimet dhe dokumentacionin që i perket aktiviteteve të verifikimit dhe markimit.

Duke pasur parasysh si më sipër, i parashtroj DPM-së kërkësën për të na dhënë autorizim për verifikim dhe vulosje të instrumentave matëse që kontrollohen ligjërisht.

SUBJEKTI

Përfaqësuesi

(.....)

ANEKSI nr. 1.2

LISTA E DOKUMENTAVE PËR APLIKIM

Dokumenta dhe shënime të nevojshme për t'u dorëzuar pranë DPM

- 1 Ekstrakt i Rregjistrat Tregtar, lëshuar nga QKB
- 2 Ekstrakt Historik i Rregjistrat Tregtar, lëshuar nga QKB
- 3 NUIS i shoqërisë së aplikuesit
- 4 Dokument vërtetues se aplikanti nuk është në proces gjyqësor, administrativ, civil apo penal
- 5 Dokument vërtetues se aplikanti nuk është në proces përmbarimor
- 6 Dokument vërtetues se aplikanti ka shlyer detyrimet shtetërore në fushën e tatim-taksave
- 7 Dokument vërtetues se aplikanti ka shlyer detyrimet vendore në fushën e taksave
- 8 Dokument vërtetues se aplikanti ka shlyer detyrimet e sigurimeve shoqërore, lëshuar nga Administrata Tatimore
- 9 Tarifat që përdoren për shërbimet

Kërkesat e mësipërme, të përcaktuara në pikat 1 deri 9, përbushen me plotësimin e Formularit të Vetëdeklarimit, i cili ndodhet në Aneksin nr. 1.3 të këtij Urdhëri.

- 10 Manuali i Cilësisë (MC) S SH ISO/IEC 17025 dhe S SH ISO/IEC 17020 për subjektin që kërkon autorizim për verifikimin e instrumentave mates si matësit e energjisë elektrike, matësit e ujit dhe manuali i cilësisë S SH ISO/IEC 17020 për subjektin që kërkon autorizim për verifikimin e instrumentave jashtë fushave të sipërpërmendura
- 11 Lista e procedurave të menaxhimit dhe procedurat teknike
- 12 Organigramë (struktura organizative e laboratorit dhe nëse laboratori është pjesë e një organizmi kërkohet struktura e organizmit ku laboratori bën pjesë)
- 13 CV, Kontratë pune si dhe diplomat e studimeve që kanë kryer, e punonjësve të cilët kryejnë testime për të cilat kërkohet autorizimi dhe certifikata të trajnimit të tyre
- 14 Prova të kualifikimit të drejtuesit të laboratorit zëvendësitet të tij/saj
- 15 Statuti apo rregullore e brendshme
- 16 Checklist sipas S SH ISO/IEC 17025 dhe S SH ISO/IEC 17020 për subjektin që kërkon autorizim për verifikimin e instrumentave matës si matësit e energjisë elektrike,

- matësit e ujit dhe Checklist S SH ISO/IEC 17020 për subjektin që kërkon autorizim për verifikimin e instrumentave jashtë fushave të sipër përmendura
- 17 Përshkrimi teknik i vulave të sigurisë që propozohen të përdoren nga subjekti
- 18 Mostra (3 copë) të vulave të sigurisë që propozohen të përdoren nga subjekti
- 19 Raport mbi pjesëmarrjen në krahasimet ndërlaboratorike dhe rezultatet në to
- 20 Certifikatat e kalibrimit të Instrumentave
- 21 Planimetria e laboratorit dhe vendosja e pajisjeve

ANEKSI nr. 1.3

FORMULARI I VETËDEKLARIMIT

Tiranë më/...../.....

VETËDEKLARIM

Drejtuar: Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë

Unë i nënshkruari _____, i datëlindjes _____ deklaroj që
jam banues në _____, adresë _____
me seli _____, tel. _____, cel. _____
_____ dhe me dokument identifikimi/nr. i pasaportës _____.

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

1. Jam subjekt i regjistruar me statusin Aktiv në QKB dhe objekti i aktivitetit të jetë shërbime ligjore në fushën e metrologjisë.
2. Nuk jam në proces gjyqësor administrativ, civil dhe penal.
3. Subjekti që përfaqësoj nuk është në proces gjyqësor administrativ, civil dhe penal në fushën për të cilën aplikon.
4. Nuk jam në proces përbartimor.
5. Kam shlyer të gjitha detyrimt vendore në fushën e tatim-taksave nga administratata tatimore dhe ajo vendore deri në momentin e aplikimit.
6. Për aktivitetin që kërkoj të autorizohem, do të përdorë tarifat të cilat nuk i tejkalojnë tarifat të përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse.

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se të gjitha të dhënat e mësiperme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Emer Mbiemër

Firmë

ANEKSI nr. 1.4

FORMULARI I AUTORIZIMIT

Tiranë, më/...../.....

VENDIM ADMINISTRATIV

Nr....., datë.....

VENDIM ADMINISTRATIV PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR VERIFIKIM TË INSTRUMENTAVE MATËS LIGJIRISHT TË KONTROLLUARA

Në përgjigje të kërkesës së aplikimit të subjektit....., në zbatim dhe mbështetje të ligjit Nr. 126/2020, datë 15.10.2020 “Për Metrologjinë”, Neni 39, pika 2, si dhe të Urdhërit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr....., datë..... “Rregullore për autorizimin e personave juridikë për kryerjen e veprimtarive në metrologjinë ligjore dhe autorizimin e personave juridikë ose fizikë për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumentave matëse”, duke marrë në konsideratë raportin e grupit të vlerësimit,

VENDOSA:

- 1. Subjektit Juridik “.....”, me numër NIPT-I, i jepet autorizimi për verifikim dhe vulosje të instrumentave matës si vijon:**

.....
.....
.....

Përshkruhet lista e instrumentave matës ligjërisht të kontrolluara të cilët do të verifikoohen nga subjekti sipas këtij autorizimi.

- 2. Instrumentat që do të përdoren për verifikim janë:**

.....
.....
.....

Përshkruhet lista e Instrumentave Referues duke paraqitur modelin, prodhuesin, klasën e saktësisë, numrin e certifikatës së kalibrimit, subjektin që ka kryer kalibrimin, data e kalibrimit, etj.

- 3. Instrumentat ndihmës që do të përdoren janë:**

.....
.....
.....

Përshkruhet lista e Instrumentave ndihmës duke paraqitur modelin, prodhuesin, klasën e saktësisë, numrin e certifikatës së kalibrimit, subjektin që ka kryer kalibrimin, data e kalibrimit, etj.

- 4. Vula e sigurisë që do të përdoret:**

Përshkruhet vula sigurisë së miratuar, parametrat e saj teknike dhe konstruktive.

5. Zona e juridiksionit (territoriale) për kryerjen e aktivitetit është

Subjekti kryen aktivitetin në territorin nëpërmjet instrumentave bazuar në kontratën tip të shërbimit e cila është e rregulluar dhe e miratuar nga autoritetet përkatëse në zbatim të akteve ligjore në fuqi.

6. Raportimi i aktivitetit të kryer nga subjekti i autorizuar.

Subjekti i autorizuar do të informojë DPM çdo 3 muaj në lidhje me aktivitetin e kryer. Forma e informimit do të jetë në formë shkresore dhe elektronike.

7. Ky autorizimi hyn në fuqi me datën dhe është i vlefshëm për 4 (katër) vjet.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I METROLOGJISË

PJESA 2

“KËRKESAT PËR AUTORIZIM TË PERSONAVE JURIDIKË JASHTË DPM PËR TË KRYER EKSPERTIZËN METROLOGJIKE”

Pika 1

Bazuar në Ligjin Nr. 126/2020, datë 15.10.2020 “Për Metrologjinë”, nen 34, pika 1 Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) autorizon një person juridik jashtë DPM-së për të kryer ekspertizën metrologjike. Në rastet kur shërbimet, objekt i këtij ligji, kryhen nga persona juridike privatë, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, çdo ekspertizë metrologjike do të kryhet nga trupa ndërkombetarë të akredituar.

Pika 2

Ekspertiza metrologjike përfshin: Testimet e jashtëzakonshme dhe matjet zyrtare të një instrumenti matës në bazë të një vendimi gjykate, kur rezulton e nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, për shërbimet.

- Testimet jashtë radhe të instrumentave matës ligjërisht të kontrolluara, në rast të dyshimit për funksionimin e rregullt të tyre dhe,
- Matjet zyrtare, (matjet e këruara si prova/dëshmi, në procedurat ose në marrjen e vendimit nga trupa qeveritare ose gjykatat).

Pika 3

Personat juridikë, të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) për verifikim, ose të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) të Shqipërisë për testimin e instrumentave matës ligjërisht të kontrolluar, autorizohen për kryerjen e ekspertizës metrologjike.

Personat juridikë të autorizuar nga DPM për verifikim të instrumentave matës ligjërisht të kontrolluar, nuk do të kryejnë ekspertizë metrologjike për ato instrumenta, të cilëve u kanë mundësuar shërbimin e verifikimit.

Pika 4

Kërkесat që duhet të plotësohen për dhënien e së drejtës (autorizimit) për të kryer ekspertizën metrologjike, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM), janë të njëjta si kërkesat dhe procedurat e përshkruara - në Pjesën I, Pika 3.

Pika 5

Procedura për dhënien e autorizimit për të kryer ekspertizën metrologjike fillon me plotësimin dhe nënshkrimin nga ana e përfaqësuesit të personit juridik, të kërkësës sipas modelit, bashkëngjitur kësaj Rregulloreje (Aneksi 2. l)

Pika 6

Procedurat për marrjen e autorizimit janë si më poshtë:

- a) Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM), pas marrjes së kërkesës, fillon procesin e vlerësimit të aplikimit për autorizim.
- b) Brenda 20 ditëve nga data e aplikimit të subjektit, Grupi i Vlerësimit, i ngritur me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, në përbërje të të cilit duhet të ketë: një përfaqësues të Drejtorisë së Metrologjisë Shkencore dhe Industriale në varësi të fushës së aplikimit, një përfaqësues nga Drejtoria e Metrologjisë Ligjore, një përfaqësues të Sektorit të Cilësisë, një përfaqësues nga Sektori i Financës dhe një përfaqësues nga Sektori Juridik shqyrton dokumentacionin e aplikimit, të përcaktuar në Pjesën I, Pika 3. Nëse është e nevojshme, aplikanti ftohet të marrë masa korriguese.
- c) Në rast se dosja e aplikantit përmban dokumentacion të rregullt, Grupi i Vlerësimit kryen vizitën në ambientet e personit juridik, brenda afatit 30 ditor nga marrja e kërkesës. Gjatë vizitës vlerësuese, kontrollohet gjendja e etaloneve dhe instrumentave matës, certifikatat e tyre, udhëzimet tekniko-administrative, si është implementuar sistemi i menaxhimit dhe vërtetësia e të gjithë të dhënavë të dërguara paraprakisht nga ana e personit juridik.
- ç) Në përfundim të procesit grupi i vlerësimit harton raportin përfundimtar, të cilin ia paraqet Drejtorit të Përgjithshëm të DPM-së, ku të paraqitet vlerësimi për çdo kriter, ligjor, teknik dhe administrativ.
- d) Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë vendos për nxjerrjen e Vendimit Administrativ, brenda 60 ditëve nga aplikimi. Vendimi Administrativ është i vlefshëm për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

Pika 7

Menjëherë personit juridik i jepet Vendimi Administrativ i autorizimit (sipas modelit bashkangjitur - Aneksi 2.2) për ushtrimin e së drejtës për të kryer ekspertizën metrologjike të instrumentave matës.

Pika 8

Nëse personi juridik i autorizuar kërkon të shtojë, ose të heqë nga përdorimi instrumenta matës të ndryshëm apo kërkon të bëjë ndryshime të procedurave dhe/osse personelit, atëherë ai njofton menjëherë me shkrim Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë (DPM).

Nëse personi juridik i autorizuar kërkon të shtojë instrumenta matës të ndryshëm Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) vlerëson dokumentacionin e aplikimit, dhe nëse dosja përmban dokumentacion të rregullt realizon vizitën vlerësuese dhe testimet përkatëse, nëpërmjet një grupi të ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm brenda 30 ditëve, nga data e dorëzimit të kërkesës nga personi juridik. Në përbërje të grüpuit duhet të ketë: një përfaqësues të Drejtorisë së Metrologjisë Shkencore dhe Industriale në varësi të fushës së aplikimit, një përfaqësues nga Drejtoria e Metrologjisë Ligjore, një përfaqësues të Sektori i Sigurimit të Cilësisë, një përfaqësues nga Sektori i Financës dhe një përfaqësues nga Sektori Juridik.

Ky grup i paraqet Drejtorit të Përgjithshëm një relacion, në të cilin paraqitet përbushja ose jo e kërkesave përkatëse.

Drejtori i Përgjithshëm harton një ndryshim Vendimi Administrativ, në të cilin reflektohen ndryshimet në instrumenta, procedura.

Pika 9

Pas dhënis së autorizimit, personit juridik i bëhen kontolle monitoruese nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM), të paktën një herë brenda periudhës së vlefshmërisë së autorizimit.

Gjatë vizitës monitoruese/performancës, DPM kontrollon:

- a) Si janë zbatuar kërkesat e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, (regjistrime teknike dhe regjistrime të cilësisë të bëra për periudhën që vlerësohet).
- b) Certifikatat e kalibrimit të Instrumentave matës dhe instrumentave ndihmës.
- c) Testime konformiteti të realizuar me instrumentat matës.

Pika 10

Autorizimi është i vlefshëm për një periudhë 4 vjeçare.

Në përfundim të afatit 4 vjeçar të autorizimit, personi juridik duhet të njoftojë dhe t'i bëjë përsëri kërkesë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) duke kërkuar ri-autorizim.

Në këtë rast, personi juridik duhet të ndjekë të njëjtën procedurë të përshkruar në këtë Urdhër, për dhënien e autorizimit.

Pika 11

Autorizimi është i pavlefshëm, kur:

- a) Mbaron afati i vlefshmërisë së autorizimit.
- b) Drejtori i Përgjithshëm i Metrologjisë nxjerr vendim për anullimin e autorizimit.
- c) Personi juridik i autorizuar heq dorë, me shkrim, nga autorizimi.

Pika 12

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë shfuqizon Vendimin për Autorizim, në rastet kur personi juridik:

- a) Kryen shërbime verifikimi, në kundërshtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Vendimin e Autorizimit nga e DPM-së.
- b) Nuk përdor instrumenta të kalibruar nga NMI që ka deklaruar aftësitë matëse kalibruese (CMC) në database e BIPM, ose nga një laborator i akredituar nga një trupë akreditimi nënshkruese e Marrëveshjes shumëpalëshe të Akreditimit të Organizatës Europiane të Akreditimit (EA MLA) ose nënshkruese e Marrëveshjes së Njohjes Reciproke (ILAC-MRA) ose nga një laborator kalibrues i akredituar specifisht për kalibrimin që kërkohet nga një organizëm akreditues, i cili është nënshkrues i ILAC-MLA ose Marrëveshjeve Rajonale të Njohura nga ILAC në fushën e kalibrimit.
- c) Përdor instrumenta, të cilat janë jashtë klasës së saktësisë të parashikuar në autorizim, ose në kontratën e shërbimit.
- ç) Nuk mirëmban dokumentacionin e plotë dhe regjistrimet, sipas kërkesave të parashikuara në standarte.
- d) Nuk përdor tarifat e përcaktuara për kryerjen e shërbimit të ekspertizës.

Pika 13

Menjëherë pas marrjes së vendimit për shfuqizimin e Autorizimit, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) njofton me shkrim personin juridik.

Pika 14

Personit juridik, të cilit i është revokuar autorizimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM), i hiqet gjithashtu e drejta për riaplikim për autorizim, për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

Personit juridik, i cili heq dorë vetë nga autorizimi, i hiqet e drejta për riaplikim për autorizim për një periudhë 10 (dhjetë) vjeçare.

Pika 15

Anekset e mëposhtme janë plotësime të kësaj Rregulloreje:

Aneksi 2.1 Formulati Tip i Aplikimit për dhënien e autorizimit

Aneksi 2.2 Formulati Tip i Vendimit administrativ për dhënien e autorizimit

ANEKSI nr. 2.1

FORMULARI I KËRKESËS

**PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR PERSONAT JURIDIKË JASHTË DPM-së
PËR KRYERJEN E EKSPERTIZËS METROLOGJIKE**

1. Emërtimi dhe adresa e subjektit (laboratorit) verifikues:

.....

2. Emri, mbiemri i përfaqësuesit të subjektit verifikues:

3. Ndërtesa dhe kushtet ambientale të laboratorit:

4. Emri, mbiemri dhe kualifikimi i personelit verifikues:

5. Etalonët, instrumentat matës kontrolluese (që do të përdoren në aktivitetin e ekspertizës metrologjike) dhe karakteristikat e tyre:

6. Llojet e instrumentave matëse që subjekti është në gjendje të verifikojë:

7. Rregulloret që përdorën për përcaktimin e treguesve të metrologjisë:

8. Deklaroj se nuk kryej riparimin e instrumentave matës ligjërisht të kontrolluar.

9. Deklaroj se njoh:

a. Ligjin Nr. 126/2020, datë 15.10.2020 “Për Metrologjinë”.

b. Rregulloren “Për autorizimin e personave juridike për kryerjen e veprimitarive në metrologjinë ligjore dhe autorizimin e personave juridike ose fizikë për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumentave matëse”.

c. Të gjitha aktet nënligjore që i përkasin ekspertizës metrologjike.

10. Gjithashtu marr përsipër:

a. të respektoj plotësisht rregullat dhe detyrimet që përbajnë dokumentet e mësipërme

b. të bëj pagesën e tarifës përkatëse në llogarinë e DPM

c. të plotësoj rregullisht dhe t'ia paraqesë DPM-së (me kërkesë të saj) regjistrimet dhe dokumentacionin që i përket aktiviteteve të ekspertizës metrologjike.

Duke pasur parasysh si më sipër, i parashtroj DPM-së kërkesën për të na dhënë autorizim për kryerjen e ekspertizës metrologjike.

SUBJEKTI

Përfaqësuesi

(.....)

ANEKSI nr. 2.2

FORMULARI I AUTORIZIMIT

Tiranë, më/...../.....

VENDIM ADMINISTRATIV

Nr....., datë.....

PËR AUTORIZIMIN E PERSONAVE JURIDIKE JASHTË DPM-së PËR KRYERJEN E EKSPERTIZËS METROLOGJIKE

Në zbatim të Rregullores ‘Për autorizimin e personave juridike për kryerjen e veprimtarive në metrologjinë lligore dhe autorizimin e personave juridike ose fizikë për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumentave matëse”, Subjektit Juridik i jepet Autorizimi për kryerjen e ekspertizës metrologjike:

- 1.....
- 2.....

Etalonet dhe instrumentat matëse verifikuese që lejohen janë:

- 1.....
- 2.....

Ekspertiza metrologjike kryhet konform Urdhëresave - dhe/ose rregulloreve....

- 1.....
- 2.....

Kryerjen e ekspertizës metrologjike kanë të drejtë specialistët e mëposhtëm:

- 1.....
- 2.....

Llojet e aktiviteteve të ekspertizës metrologjike që lejohen të kryhen nga i autorizuari:

- 1.....
- 2.....

Ky autorizim hyn në fuqi më datën

I vlefshëm deri më datën

DREJTORI I PERGJITHSHËM I METROLOGjisë

(.....)

PJESA 3

“KËRKESAT DHE PROCEDURA PER DHËMEN E AUTORIZIMIT PËR RIPARIM, VERIFIKIM DHE VULOSJE TË INSTRUMENTAVE MATËSE LIGJËRISHT TË KONTROLLUAR”

Pika 1

Me këtë rregullore, bazuar në Ligjin 126/2020, datë 15.10.2020 “Për Metrologjinë”, nen 39, pika 3, përcaktohen kushtet të cilat duhet të plotësojë personi juridik, ose fizik për marrjen e të drejtës (autorizimit) për riparim, verifikim dhe për vulosje të instrumentave matës ligjërisht të kontrolluar.

Pika 2

- a. Në bazë të Ligjit Nr. 126/2020, datë 15.10.2020 “Për Metrologjinë”, nen 20, pika b) përdoruesi i instrumentave matës ligjërisht të kontrolluara ka për detyrë të mirëmbajë instrumentat matës ligjorë në kushte teknike që sigurojnë saktësinë e matjeve.
- b. Në periudhën ndërmjet dy verifikimeve periodike të njëpasnjëshme të një instrumenti matës, shpesh ndodh që ai të difektohet gjatë përdorimit. Në këto raste nga pronari duhet të merren masa për riparimin e tij.
- c. Meqenëse pas riparimit instrumenti matës duhet të verifikohet (verifikim i cili në këtë rast është i pa planifikuar të kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) ose subjekti i autorizuar për verifikim), atëherë lind nevoja që kjo e drejtë t'i jepet përkohësisht riparuesit. Kjo bën të mundur që instrumenti matës të mund të përdoret nga subjekti menjëherë pas riparimit.

Pika 3

Kërkesat që duhet të plotësohen për dhënien subjektit juridik/fizik, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM), të së drejtës (autorizimit) për riparimin, verifikimin dhe vulosjen me vlefshmëri të përkohshme 30 (tridhjetë) ditë të instrumentave matës që i nënshtrohen verifikimit të detyrueshëm periodik ligjor, janë të njëjta si kërkesat dhe procedurat e përshkruara në Pjesen I, Pika 3, me përjashtim të pikës II/a.

Pika 4.

Procedura për dhënien e autorizimit për riparim, verifikim dhe për vulosje të përkohshme të instrumentave matës ligjërisht të kontrolluar fillon me plotësimin dhe nënshkrimin e kërkuesës nga përfaqësuesi i personit juridik, bazuar në modelin e miratuar bashkëngjitur kësaj Rregulloreje (Aneksi 3. l).

Pika 5

a) Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM), pas marrjes së kërkesës, fillon procesin e vlerësimit të aplikimit për autorizim.

b) Brenda 20 ditëve nga data e aplikimit të subjektit, Grupi i Vlerësimit të përbërë nga një përfaqësues nga Drejtoria e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale në varësi të fushës së aplikimit, një përfaqësues nga Drejtoria e Metrologjisë Ligjore, një përfaqësues nga Sektori i Sigurimit të Cilësisë, një përfaqësues nga Sektori i Financës dhe një përfaqësues nga Sektori Juridik, i ngritur me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, shqyrton dokumentacionin e aplikimit, të përcaktuar në pikën 3. Nëse është e nevojshme, aplikanti ftohet të marrë masa korriguese, jo më vonë se 7 ditë nga data e shkresës së DPM.

c) Në rast se dosja e aplikantit përmban dokumentacion të rregullt, Grupi i vlerësimit kryen vizitën në ambientet e personit juridik, brenda afatit 30 ditor nga marrja e kërkesës. Gjatë vizitës vlerësuese, kontrollohet gjendja e etaloneve dhe instrumentave matës, certifikatat e tyre, udhëzimet tekniko-administrative, si është implementuar sistemi i menaxhimit dhe vërtetësia e të gjithë të dhënave të dërguara paraprakisht nga ana e personit juridik.

ç) Në përfundim të procesit, grupi i vlerësimit harton raportin perfundimtar, të cilin ia paraqet Drejtorit të Përgjithshëm të DPM-së, ku të paraqitet vlerësimi për çdo kriter ligjor, teknik dhe administrativ.

d) Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë vendos për nxjerrjen e Vendimit Administrativ, brenda 60 ditëve nga aplikimi. Vendimi Administrativ është i vlefshëm për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

Pika 6

Menjëherë personit juridik i jepet Vendimi Administrativ i autorizimit (sipas modelit bashkangiut — Aneksi 3.2) për ushtrimin e së drejtës për të kryer riparim, verifikim dhe vulosje të përkohshme të instrumentave matës.

Pika 7

Nëse personi juridik i autorizuar kërkon të shtojë, ose të heqë nga përdorimi instrumenta matës të ndryshëm apo kërkon të bëjë ndryshime të procedurave dhe/ose personelit, atëherë ai njofton menjëherë me shkrim Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë (DPM).

Nëse personi juridik i autorizuar kërkon të shtojë instrumenta matës të ndryshëm Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) vlerëson dokumentacionin e aplikimit, dhe nëse dosja përmban dokumentacion të rregullt realizon vizitën vlerësuese dhe testimet përkatëse, nëpërmjet një grupi të ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm brenda 30 ditëve, nga data e dorëzimit të kërkesës nga personi juridik, në përbërje të të cilit duhet të ketë: një përfaqësues të Drejtorisë së Metrologjisë Shkencore dhe Industriale në varësi të fushës së aplikimit, një përfaqësues nga Drejtoria e Metrologjisë Ligjore, një përfaqësues të nga Sektori i Sigurimit të Cilësisë, një përfaqësues nga Sektori i Financës dhe një përfaqësues nga Sektori Juridik.

Ky grup i paraqet Drejtorit të Përgjithshëm një relacion, në të cilin paraqitet përbushja ose jo e kërkesave përkatëse.

Drejtori i Përgjithshëm harton një ndryshim Vendimi Administrativ, në të cilin reflektohen ndryshimet në instrumenta, procedura.

Pika 8

Me marrjen e autorizimit, personi fizik/juridik riparues, ka të drejtë që pas riparimit të instrumentit matës ta verifikojë, ta vulosë atë dhe t'i lëshojë pronarit të tij një certifikatë verifikimi të përkohshme.

Certifikata dhe vula ligjerojnë përdorimin e instrumentit matës deri në 30 (tridhjetë) ditë. Menjëherë pas vulosjes dhe dhënies së certifikatës, riparuesi është i detyruar të njoftojë Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) ose personat juridike të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për kryerjen e verifikimeve të instrumentave matës, ligjërisht të kontrolluar ku është bërë vulosja e përkohshme, me qëllim që verifikimi jashtë rradhe i instrumentit të riparuar, të kryhet brenda afatit ligjor deri në 30 (tridhjetë) ditë.

Pika 9

Riparuesi nuk ka të drejtë të bëjë shënimë në Librezën (dokumentin) e verifikimit të instrumentit matës, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM).

Pika 10

Deri në 30 (tridhjetë) ditë nga dita e vulosjes së instrumentit matës prej personit fizik dhe/ose juridik riparues, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM), personat juridikë të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për kryerjen e verifikimeve të intrumenave matës, ligjërisht të kontrolluar, duhet të bëjë verifikimin e instrumentit matës të pajisur me leje të përkohshme dhe të zëvendësoje vulën dhe certifikatën e personit juridik, fizik riparues me ato të vetat.

Pika 11

Shpenzimet e verifikimit paguhen nga riparuesi, në rastin kur gjatë kryerjes së këtij verifikimi jashtë rradhe (që kryhet nga metrologu i autorizuar dhe/ose personi juridik të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për kryerjen e verifikimeve të instrumentave matës, ligjërisht të kontrolluar), instrumenti matës i vulosur nga personi fizik/juridik riparues, rezulton i parregullt, edhe pse nuk ka ndërhyrje teknike nga të tjerët dhe instrumenti matës është mbajtur në kushte të përshtatshme.

Pika 12

Pas dhënies së autorizimit personit juridik i bëhen kontolle monitoruese/performancës nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM), jo më shumë se 1 (një) herë në vit.

Gjatë vizitës monitoruese/performancës, DPM kontrollon:

- Si janë zbatuar kërkesat e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, (regjistrime teknike dhe regjistrime të cilësisë të bëra për periudhën që vlerësohet).
- Certifikatat e kalibrimit të Instrumentave matës dhe instrumentave ndihmës.
- Testime konformiteti të realizuar me instrumentat matës.

Pika 13

Autorizimi është i vlefshëm për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

Në përfundim të afatit 4 vjeçar të autorizimit, personi juridik duhet të njoftojë dhe t'i bëjë përsëri kërkesë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) duke kërkuar ri-autorizim.

Në këtë rast, personi juridik duhet të ndjekë të njëjtën procedurë të përshkruar në këtë Urdhër, për dhënien e autorizimit.

Pika 14

Autorizimi është i pavlefshëm, kur:

- a) Mbaron afati i vlefshmërisë së autorizimit.
- b) Drejtori i Përgjithshëm i Metrologjisë nxjerr vendim për anullimin e autorizimit.
- c) Personi juridik i autorizuar heq dorë, me shkrim, nga autorizimi.

Pika 15

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë shfuqizon Vendimin për Autorizim, në rastet kur personi juridik i autorizuar:

- a) Kryen shërbime verifikimi, në kundërshtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Vendimin e Autorizimit nga e DPM-së.
- b) Nuk përdor instrumenta të kalibruar nga NMI që ka deklaruar aftësitet matëse kalibruese (CMC) në database e BIPM ose nga një laborator i akredituar nga një trupë akreditimi nënshkruese e Marrëveshjes shumëpalëshe të Akreditimit të Organizatës Ndërkombëtare të Akreditimit (EA MLA) ose nënshkruese e Marrëveshjes së Njohjes Reciproke (ILAC MRA) ose nga një laborator kalibrues i akredituar specifikisht për kalibrimin që kërkohet nga një organizëm akreditues i cili është nënshkrues i ILAC-MLA ose Marrëveshjeve Rajonale të Njohura nga ILAC në fushën e kalibrimit.
- c) Përdor instrumenta, të cilat janë jashtë klasës së saktësisë të parashikuar në autorizim, ose në kontratën e shërbimit.
- ç) Nuk mirëmban dokumentacionin e plotë dhe regjistrimet sipas kërkesave të parashikuara në standarte.

Pika 16

Menjëherë pas marjes së vendimit për revokimin e Autorizimit, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) njofton me shkrim personin juridik.

Pika 17

Personit juridik, të cilit i është shfuqizuar autorizimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM), i hiqet gjithashtu e drejta për riaplikim për autorizim për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

Personit juridik, i cili heq dorë vetë nga autorizimi, i hiqet e drejta për riaplikim për autorizim për një periudhë 10 (dhjetë) vjeçare.

Pika 18

Anekset e mëposhtme janë plotësime të kësaj Rregulloreje:

Aneksi 3.1 Formulari Tip i Aplikimit për dhënien e autorizimit

Aneksi 3.2 Formulari Tip i Vendimit administrativ për dhënien e autorizimit

ANEKSI nr. 3.1

FORMULARI I KËRKESËS

**PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT
PËR RIPARIM, VERIFIKIM DHE PËR VULOSJE TË PËRKOOSHME TË
INSTRUMENTAVE MATËSE LIGJËRISHT TË KONTROLLUARA**

1. Emërtimi dhe adresa e subjektit riparues:
2. Emri, mbiemri i përfaqësuesit të subjektit riparues
3. Emri, mbiemri dhe kualifikimi i personelit riparues verifikues:
4. Etalonët, instrumentet matëse kontrolluese dhe karakteristikat e tyre:
5. Llojet e instrumenteve matëse që subjekti është në gjendje të riparojë:
6. Rregulloret që përdorën për përcaktimin e treguesve të metrologjisë:
7. Deklaroj se njoh:
 - a. Ligjin nr. 126/2020, datë 15.10.2020 “Për Metrologjinë”,
 - b. Rregulloren “Për autorizimin e personave juridike për kryerjen e veprimitarive në metrologjinë ligjore dhe autorizimin e personave juridikë ose fizikë për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumentave matëse”,
 - c. Aktet e tjera nënligjore të metrologjisë që i përkasin verifikimit.
8. Gjithashtu marr përsipër:
 - a. Të respektoj plotësisht rregullat dhe detyrimet e përmbajtura në dokumentacionet e mësipërme
 - b. Të derdh në llogarinë rrjedhëse të DPM-së Nr.....shumën sipas tarifës përkatëse të miratuar nga Ministria e Financave
 - c. Të plotësoj rregullisht dhe të paraqes sa herë që të më kërkohet nga DPM-ja regjistrimin dhe dokumentacionin që i përket aktiviteteve të verifikimit dhe vulosjes (markimit).

Duke pasur parasysh si më sipër, i parashtroj DPM-së kërkësën për të na dhënë autorizimin për riparim, verifikim dhe përvulosje të përkooshme të instrumentave matëse ligjërisht të kontrolluara.

Firma.....
Përfaqësuesi i firmës
(.....)

ANEKSI nr. 3.2

FORMULARI I AUTORIZIMIT

Tiranë, më/...../.....

VENDIM ADMINISTRATIV

Nr....., datë.....

PËR AUTORIZIM PËR RIPARIM, VERIFIKIM DHE VULOSJE TË INSTRUMENTAVE MATËS LIGJËRISHT TË KONTROLLUAR

Subjektit juridik ose fizik _____ i jepet e drejta që në zbatim të Rregullores “Për autorizimin e personave juridikë për kryerjen e veprimtarive në metrologjinë ligjore dhe autorizimin e personave juridikë ose fizike për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumenteve matëse” të riparojë, të verifikojë dhe të vulosë përkohësisht për një muaj, instrumentet matës ligjërisht të kontrolluar.

Etalonët dhe instrumentet matëse verifikuese që lejohen janë:

1.
2.

Kontrolli dhe verifikimi i instrumenteve matëse do të kryhet me dokumentacionin ligor, teknik, administrativ:

1.
2.

Kryerjen e riparimit dhe të verifikimit të instrumenteve matëse të riparuara e kanë të drejtë specialistët e më poshtëm:

1.
2.

Llojet e instrumenteve matëse që lejohen riparohen, të verifikohen dhe vulosen nga subjekti:

1.
2.

Ky autorizim hyn në fuqi më datën _____

I vlefshëm deri me datën _____

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I METROLOGJISË